

UDHËZIM
Nr.38, datë 3.11.2008

**PËR ADMINISTRIMIN E KUOTAVE PËR SHTETASIT E HUAJ QË DO TË
STUDIOJNË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN
AKADEMIK 2008-2009, NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË**

Mbështetur në nenin 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në zbatim të pikës 1 ç dhe 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1037, datë 2.7.2008 “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në IAL publike, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009”

UDHËZOJ:

1. Studentët që vijnë në kuadër të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe ose shumëpalëshe në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2008-2009, të përzgjidhen, për programet e studimit të kërkuara, në bazë të dosjeve të ardhura nga përfaqësitë diplomatike ose nga ministritë e arsimit të vendeve përkatëse.

2. Numri i kuotave të përealizuara për studentë që vijnë në kuadër të marrëveshjeve shtetërore dypalëshe ose shumëpalëshe plotësohet nga shtetas të huaj që nuk vijnë në kuadër të këtyre marrëveshjeve.

3. Kjo kategori studentësh duhet të paraqesë në sektorin e marrëdhënieve me jashtë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për programin e studimit, në të cilin do të studiojë.

b) Formularin e aplikimit, të plotësuar.

c) Fotokopjen e dokumentit personal të identitetit, të përkthyer dhe të legalizuar në gjuhën shqipe.

d) Fotokopje të njësuar të diplomës së shkollës së mesme, bashkë me vërtetimin nga Ministria e Arsimit dërguese se diploma është e vlefshme për të vazhduar studimet e larta.

e) Certifikatën mjekësore të përkthyer dhe të legalizuar.

f) Kopjen e lejeqendrimit për shtetasit e huaj, lëshuar nga Ministria e Brendshme.

4. Përzgjedhja e studentëve, sipas pikës 2 të këtij udhëzimi, të kryhet pasi të shqyrtohet nga Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë dhe nga sektori i marrëdhënieve me jashtë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dokumentacioni i paraqitur nga këta shtetas të huaj.

5. Ministria e Arsimit dhe Shkencës u dërgon institucioneve publike të arsimit të lartë listën e studentëve të përzgjedhur sipas këtij udhëzimi, për t’u regjistruar në programet e studimit përkatës.

6. Ngarkohen Zëvendësministri i Arsimit të Lartë, Drejtoria e Politikave të Arsimit të Lartë, sektori i marrëdhënieve me jashtë, rektoratet e institucioneve publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Fatos Beja